



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 379/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (VV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 11.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET ankesa si e bazuar.

Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 3800 (tremijetetëqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 09.12.2010, PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik VV, në të cilën pretendohet se më datë 08.12.2010 në ora 19:35, në rrugën e “UÇK-së” në Prishtinë, subjekti politik LDK, ka mbuluar posterat e subjektit politik VV, me posterat e kandidatit të tyre për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Mustafë Krasniqi, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur 1 (një) fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterat e kandidatit për Kuvend të Republikës së Kosovës Mustafë Krasniqi nga radhët e subjektit politik LDK, është vendosur mbi posterin e subjektit politik VV. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik LDK, më datë 09.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 10.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, nuk mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik LDK, sipas afatit të caktuar.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se subjekti politik LDK shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur në vazhdimësi, rrjedhimisht konsiderohet recidivist, rrethanë e cila ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar në gjobë. Prandaj nga arsyet e lartcekura, ne kuptim te nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 379/2010 më datën 11.12.2010

